



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-020/04-283856/19, më 18. 11. 2019

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për vlerësim teknik për rrezikshmëri të objekteve banuese dhe infrastrukturore.
- II. Anëtarë e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. Fexhri Hyseni, kryetar;
 2. Xhevdet Ibrahimaj, anëtar;
 3. Xhemshit Gashi, anëtar;
 4. Albana Berisha, anëtare;
 5. Jonuz Zymberi, anëtar;
 6. Krenar Xhaferi, anëtar.
- III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi janë: të zbatoj në përpikshmëri Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të bëjë vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera të objekteve të banimit, kulturave bujqësore, pyjeve etj, të bëjë vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë së objekteve të dëmtuara nga vjetërsia e tyre apo faktorët tjerë (ku duhet vlerësuar stabiliteti statik i objektit - i banuar, jo i banuar), të bëjë vlerësimin e dëmeve dhe vlerësimin e rrezikshmërive.
- IV. Për kryerjen e detyrave si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I D O R Ë Z O H E T:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

